



# Analizë mbi kornizën ligjore kundër pasurisë së përvetësuar në mënyrë të paligjshme

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë në Kosovë si dhe NED. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e Ambasadës Norvegjeze si dhe NED.

**Prill 2011, Prishtinë**



## HYRJJE

**“Nullum crimen, nulla poena sine lege praevia”**

Faqe | 2

(Nuk ka dënim për vepër penale nëse nuk e parasheh ligji)

Njëra nga fushat në të cilat Kosova po përballet me probleme të shumta është ajo e rendit dhe ligjit, gjë e cila po ndikon në mirëqenien e njerëzve që jetojnë këtu. Në këtë kontekst, infrastruktura ligjore joadekuata dhe vështirë e zbatueshme vazhdon të jetë ndër pengesat kryesore në vendosjen e shtetit të së drejtës. Megjithëse ‘sundimi i ligjit’ është pjesë e retorikës politike ditore që nga përfundimi i luftës, kjo vështirë mund të arrihet në një sistem i cili për 9 vite është qeverisur të paktën nga 4 lloje të ligjeve themelore:

1. Legjislacioni i UNMIK-ut
2. Ligjet e trashëguara të RSFJ-së
3. Ligjet e Serbisë të nxjerra pas vitit 1989, të cilat PSSP-ja nuk i konsideronte diskriminuese, si dhe
4. Ligjet e miratuara nga IPVQ-të

Ky sistem i përbërë nga një shumësi dhe laramani ligjesh e bënte të pamundur shmangien e kolizionit, ndërkohë që kjo trashëgimi vazhdon të pengojë konsolidimin e kapaciteteve vendore për të zhvilluar dhe zbatuar legjislacion të qartë e koherent.

Në veçanti kjo vlen kur janë në pyetje çështje të ndjeshme si luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjë që gjithashtu kërkon institucione gjyqësore të pavarura dhe të konsoliduara. Duke shfrytëzuar këtë amulli të kornizës ligjore dhe një gjyqësor jofunksional, krimi i organizuar ka krijuar një terren gjithëpërfshirës nga i cili individë apo grupe të caktuara kanë krijuar pasuri marramendëse.

Prandaj pa një bazë të qartë ligjore dhe pa sistem të pavarur me të gjithë mekanizmat përcjellës, vështirë të arrihen rezultate konkrete në luftimin e krimit të organizuar, apo konfiskimi i pasurisë së krijuar në mënyrë të paligjshme.

Konfiskimi i pasurisë nënkupton marrjen e përhershme të sendeve në bazë të vendimit të formës së prerë nga ana e gjykatës kompetente, kurse si pasuri që mund të sekuestrohen konsiderohen sendet e luajtshme e të paluajtshme, paratë dhe letrat me

vlerë, të cilat janë në qarkullim juridik, ndërsa me sekuestrim nënkuptohet marrja e përkohshme e tyre në pajtim me ligjin<sup>1</sup>.

Kjo analizë e shkurtër synon të nxjerrë në pah hendeqet, pikat kryesore të mungesës së koherencës dhe paqartësitë e ligjeve kornizë kundër pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme në Kosovë. Kjo bëhet duke u fokusuar në Kodin e Përkohshëm Penal dhe Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Pasi identifikohen mangësitë kyçe specifikisht në ligjin 'tematik', pjesa më e rëndësishme e analizës përpiqet të shpalosë në hollësi hendeqet strukturore të dy ligjeve.

Në fund të analizës krahas me sjelljen e të dhënave nga përvoja e shteteve fqinje, jepen edhe disa përfundime e rekomandime.

## **MANGËSITË KYÇE TË LIGJEVE KORNIZË KUNDËR PASURIMIT TË KUNDËRLIGJSHËM**

Më tepër se një vit nga hyrja e tij në fuqi nuk ka lëvizje/veprime serioze në zbatimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe të Sekuestruar. Përveç kësaj, problem parësor për zbatim është mungesa e një ligji themelor që do t'i obligonte autoritetet ta konfiskojnë pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme, duke e bërë atë pjesë integrale të hetimit, ndjekjes dhe ndëshkimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pra, në vend që shteti të vendosë bazën ligjore për të kodifikuar dhe sanksionuar veprimet që mundësojnë fitimin e pasurisë në mënyrë të kundërligjshme, praktikë kjo e ndjekur nga pothuajse të gjitha vendet e tjera, është miratuar një ligj dytësor për administrimin e pasurisë së sekuestruar.

Qëllimi dhe fushëveprimi i tij reduktohet në themelimin e një Agjencie Ekzekutive<sup>2</sup>, në kuadër të një ministrie të Qeverisë, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe të masave pasuese që synojnë vendosjen e drejtësisë retributive ('ndëshkim shpagues') ndaj pothuaj të gjithë qytetarëve të vendit (taksapaguesve). Ajo gjithashtu do të ndëshkojë abuzimin me fonde publike, duke i rikthyer ato tërthorazi në dobi të taksapaguesve.

Ky ligj, përveç se dështon të vendosë rregulla në parandalimin dhe sanksionimin e pasurimit të kundërligjshëm, në thelb ka më tepër karakter të legjislacionit sekondar.

<sup>1</sup> Ligji për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar, Neni 2, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009\\_03-L-141\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-141_al.pdf)

<sup>2</sup> Poaty, Neni 1

Pjesa dërrmuese e tij fokusohet në aspekte krejtësisht teknike të funksionimit të kësaj agjencie ekzekutive dhe të cilat duhet rregulluar nëpërmjet termave të referencës. Kjo paqartësi dhe ky hendek ligjor pamundëson vendosjen e një sistemi të efektshëm për konfiskimin e pasurisë me origjinë të dyshimtë. Kjo gjithashtu krijon një konfuzion të madh ngase nuk mund të krijohet një agjenci përderisa mungon baza ligjore për funksionimin e saj. Gjithashtu mungojnë edhe dispozitat ligjore që sanksionojnë pasurimin e kundërligjshëm dhe që rregullojnë rolin dhe përgjegjësitë e një sërë institucionesh të natyrave të ndryshme përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni kriminal në nivele dhe faza të ndryshme.

Prandaj, logjikisht organet zbatuese të natyrës ekzekutive nuk mund të funksionojnë për mungesë të ligjit bazë. Kjo përveç konfuzionit të madh tek qytetarët, krijon pasiguri ligjore, por edhe konfuzion te vetë organet gjyqësore, të cilat janë të obliguara të përndjekin dhe ndëshkojnë veprat kriminale të kësaj kategorie.

Sipas ekspertëve dhe avokatëve, është e qartë se gjykatat nuk mund të gjykojnë dhe të shqiptojnë aktgjykime të plotfuqishme për konfiskim të pasurisë në raste të tjera përpos atyre që kanë të bëjnë me vepra të rënda penale, të parapara me Kodin Penal të Kosovës (neni 82 dhe 83)<sup>3</sup>. Sipas KPK-së, pasuria e kundërligjshme mund t'u konfiskohet vetëm atyre personave që kanë kryer ndonjë vepër të rëndë penale.<sup>4</sup>

Pra nga kjo vërehet se mungon një mekanizëm ligjor me anë të së cilit do t'i nënshtroheshin verifikimit të pasurisë të gjithë ata që nuk e justifikojnë atë pasuri me të ardhurat e tyre. Mirëpo kjo bazë ligjore e cekur më lartë është e pamjaftueshme, dhe ka shumë zbrazëtira të cilat nuk është lehtë të tejkalohen.

## KODI I PENAL I KOSOVËS

Për të ilustruar më gjerësisht dhe në mënyrë më precize atë që u tha më lart, në kapitullin mbi pasurimin e kundërligjshëm ("Baza e konfiskimit të dobisë pasurore"), përcakton se: (1) askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale dhe se (2) dobia pasurore e fituar kështu konfiskohet me aktgjykim të gjykatës me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale, sipas kushteve të parapara në këtë kod.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Në Kosovë s'ka ligj për konfiskim pasurie, KOHANet, 3 prill 2011, <http://www.koha.net/index.php?cid=1,7,16866> (qasur më së fundi më 15/04/2011)

<sup>4</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Neni 82, [http://www.md-ks.org/repository/docs/Kodi\\_i\\_Perkohshem\\_Penal\\_i\\_Kosoves\\_RA\\_2003-25.pdf](http://www.md-ks.org/repository/docs/Kodi_i_Perkohshem_Penal_i_Kosoves_RA_2003-25.pdf)

<sup>5</sup> Po aty, Neni 82



Kjo bazë ligjore nuk është aspak e mjaftueshme, pasi që kodi specifikon kategorinë ligjore të 'dobisë pasurore', pa precizuar asnjërën nga kategoritë e pasurive të përcaktuara në Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Është e qartë se dobia pasurore dhe pasurimi në mënyrë të paligjshme, përveç që janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme, as nuk janë precizuar në asnjërin nga dy ligjet. Praktika kosovare i njeh dy forma të pasurimit: në mënyrë gjysmë legale apo ilegale dhe që mund të legale. Andaj kjo bazë e Kodit Penal është e pamjaftueshme dhe e paqartë për të mundësuar luftimin e efektshëm të atyre veprave penale në kryerjen e të cilave përfshihet një rrjet i madh i individëve dhe grupeve.

Për ta kuptuar më qartë çështjen në fjalë, do të fokusohemi në pjesën e kodit që përcakton mënyrën e konfiskimit të dobisë pasurore. Aty saktësohen dy mënyra. Së pari, kryesit i konfiskohen të gjitha të hollat, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pasurore që është fituar me kryerjen e veprës penale, ndërsa në rastet kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave, e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore. Sipas nevojës, gjykata mund të lejojë që të hollat të paguhen në këste gjatë një periudhe e cila nuk i tejkalon dy vite. Së dyti, çfarëdo dobie pasurore e fituar me anë të kryerjes së veprës penale mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale nëse ai e ka ditur apo ka mund ta dijë se dobia pasurore është fituar me anë të kryerjes së veprës penale. Nëse dobia pasurore është bartur te të afërmit e ngushtë, ajo konfiskohet prej tyre nëse nuk ofrojnë prova se si kompensim e kanë dhënë vlerën e plotë.<sup>6</sup> Nga kjo shihet qartë se kjo bazë ligjore është konfuze dhe lejon interpretime dhe mundësi që, për shembull, përmes korrupsionit personit të dënuar t'i jepet mundësi që pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme ta kompensojë në të holla.

Siç u tha më sipër, pasuria në ditët e sotme mund të përvetësohet përmes krimit të organizuar në mënyra të sofistikuara. Kjo mënyrë shpesh aplikohet nga njerëzit me 'jaka të bardha', të cilët nuk janë njerëz të thjeshtë, por mund të jenë pjesë e strukturave të larta politike, ekonomike, diplomatike etj., duke e bërë të vështirë që Kodi Penal të merret si bazë juridike për ndjekje dhe ndëshkim efektiv. Kjo për shkak se nëse një individ kryen vepër të kundërligjshme, apo keqpërdorim, përvetëson të mira materiale në mënyrë joligjore, nuk ka bazë juridike që atij personi ose zyrtari të mund t'i konfiskohet pasuria e fituar në këto mënyra. Për më tepër, konfiskimi lejohet në mënyrë strikte vetëm nëse gjykata kompetente jep aktgjykim të plotfuqishëm për këtë, dhe atë vetëm pasi që personi në fjalë të jetë gjykuar penalisht për vepër të rëndë penale dhe të jetë shpallur fajtor.

E gjithë kjo zbrazëti ligjore e krijuar nga organet ligjvënëse jep hapësirë shumë të rehatshme dhe lehtësi veprimi për përfitime personale nëpërmjet rrugëve joligjore. Të

<sup>6</sup> Poaty, Neni 83



gjitha këto mangësi tregojnë qartë dhe bindshëm edhe një formë tjetër të burimit të nivelit të lartë të korrupsionit e krimin të organizuar në vendin tonë.

Pjesa tjetër, e cila është po aq e rëndësishme sa edhe çështjet që u trajtuan më sipër ka të bëjë me konfiskimin e dobisë pasurore nga personat juridikë. Aty përcaktohet se vetëm në rastin kur personat juridikë përvetësojnë dobi pasurore përmes kryerjes së veprës penale ajo pasuri e organizatës, biznesit apo personit tjetër juridik konfiskohet, e jo në raste të tjera.<sup>7</sup> Edhe kjo demonstroi nevojën që ligji në fjalë të përfshijë në fushëveprimin e tij edhe raste dhe lloje të tjera të veprimeve të kundërligjshme që mundësojnë përvetësim të pasurisë së paligjshme.

## LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË KONFISKUAR APO SEKUESTRUAR

Ligji për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar apo Sekuestruar është miratuar në korrik 2009<sup>8</sup>, dhe ka për qëllim bazë themelimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar dhe përcaktimin e fushëveprimit të saj. Edhe pse mungonte një ligj kornizë që do ta rregullonte materien bazë të punës së saj, ky ligj ka hyrë në fuqi në janar 2010, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë ka marrë për obligimin themelimin e kësaj agjencie ekzekutive.

Sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Drejtësisë, në dhjetor janë mbyllur konkurset për punësim të një numri zyrtarësh që do të jenë të punësuar në këtë Agjenci<sup>9</sup>, kurse deri më tani kjo agjenci asnjëherë nuk është paraqitur publikisht për të informuar publikun mbi atë se deri ku ka arritur që të bëhet funksionale. Prandaj, në këtë kontekst lë të kuptohet se edhe pas një vit themelimi me ligj, kjo Agjenci nuk është plotësisht funksionale, të paktën për të filluar me konfiskimin e pasurisë së fituar me anë të veprave penale. Të dhënat më të fundit të publikuara këtë muaj tregojnë se pas konfiskimit janë hedhur në ankand publik tre viça.

Nga ana tjetër, ende ka shumë paqartësi lidhur me një mori rastesh penale që lidhen me përfitime pasurore. Nuk dihet nëse e kanë shpallur gjykatat e Kosovës ndonjë aktgjykim të plotfuqishëm për konfiskimin e pasurisë. Gjithashtu nuk dihet nëse ka pasur raste të tilla kush e ka kryer konfiskimin e pasurisë, sikundër që nuk dihet nëse ka pasur aktgjykime të plotfuqishme dhe nëse asnjëri nga ta nuk është ekzekutuar.

<sup>7</sup> Poaty, Neni 85

<sup>8</sup> Ligji për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009\\_03-L-141\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-141_al.pdf)

<sup>9</sup> <http://www.md-ks.org/?page=1,39>



Pra, ligji në fjalë është i mangët dhe aspak nuk plotëson bazën e nevojshme ligjore për situatën aktuale në të cilën ndodhet vendi dhe nevojën urgjente për t'i luftuar dukuritë e rënda kriminale të cilat kanë si rezultat përfitimet marramendëse të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme. Ky ligj në asnjë nen nuk i referohet Kodit Penal, për të cilin shumë ekspertë të legjislacionit pretendojnë se ekziston bazë e nevojshme.

Duket se ky ligj më shumë rregullon çështjen e ofrimit të mbështetjes logjistike gjykatave dhe me administrimin e përkohshëm të sendeve, të luajtshme ose të paluajtshme, apo disa dobive pasurore, deri sa të vijë një vendim i prerë i gjykatës kompetente. Sipas nenit 5 të këtij ligji: “Agjencia bashkëpunon dhe ndihmon gjykatën, prokurorinë, apo organet tjera kompetente për ekzekutimin e vendimeve të tyre në lidhje me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar” dhe se “Me kërkesë të prokurorisë apo gjykatës, Agjencia siguron mbështetje logjistike për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë.”<sup>10</sup>

Nga kjo shihet qartë një mospërputhshmëri e këtij ligji me dispozitat e Kodit Penal, respektivisht nenin 82, që do të thotë se ky ligj nuk paraqet asgjë më shumë sesa një angazhim formal nga ana e organeve përkatëse për të adresuar këtë aspekt shumë të rëndësishëm të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Konfuzion tjetër ka edhe sa i përket rregullimit të çështjes së shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar: “(1) Me propozim të Agjencisë prokurori apo organi tjetër kompetent kërkon nga gjykata të vendos për shitjen e një pasurie që është e zëvendësueshme dhe mund ta humbë vlerën në rast të magazinimit ose shpenzimet e magazinimit janë jo proporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. (2). Gjykata njofton palët në procedurë dhe Agjencinë lidhur me vendimin për shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.(3). Pas pranimit të vendimit të gjykatës kompetente lidhur me shitjen e pasurisë, Agjencia zhvillon procedurën për shitjen e pasurisë në pajtim me ligjet në fuqi.”<sup>11</sup>

Sipas kësaj shihet se kjo ka të bëjë me konfiskime ose sekuestrime të natyrës simbolike. Aty thuhet se në rastet kur një pasuri që është e zëvendësueshme ose humb vlerë, gjykata njofton palët lidhur me vendimin për shitje, ose agjencia fillon procedurën e shitjes në pajtim me ligjin në fuqi. Megjithatë, nuk specifikohet për çfarë ligji ose ligjesh bëhet fjalë. Ose, mbase bëhet fjalë për një ligj që rregullon vetë materien, e cila, siç u tha më sipër, nuk ekziston ende. Nga ana tjetër, nëse “ligji në fuqi” nënkupton Kodin Penal, respektivisht nenin 82 dhe 83, atëherë edhe në këtë rast, në bazë të Kodit Penal, nuk mund të zbatohet nenin 8 i këtij ligji.

<sup>10</sup> Ligji për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar, Neni 5, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009\\_03-L-141\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-141_al.pdf)

<sup>11</sup> Poaty, Neni 8



Kur jemi në një nivel më teknik, atë të shkëmbimit të informatave, ky ligj përcakton se: “Çdo person fizik apo juridik, të cilit i është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, ka të drejtë të kërkojë dhe të informohet nga agjencia për pasurinë e tij të sekuestruar ose të konfiskuar”, dhe se “Personat e tretë fizikë apo juridikë, të cilët kanë interes juridik mund të kërkojnë informacione të nevojshme nga Agjencia lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.”<sup>12</sup>

Edhe kjo dispozitë tregon se ka paqartësi në legjislacionin që synon luftimin e veprave të rënda kriminale. Me rastin e zbatimit të kësaj dispozite nga ana e gjykatës ose agjencisë, lejohet mundësia e manipulimit, shantazhit apo kërcënimit për ata njerëz që kanë blerë një pasuri të konfiskuar nga dikush që e ka fituar atë në mënyrë të paligjshme, përmes krimit të organizuar, korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe formave të tjera të krimit.

## PËRVOJAT NGA RAJONI

Krimi i organizuar, apo veprimet tjera të kundërligjshme përmes të cilave arrihet përvetësimi i paligjshëm i pasurisë nuk është i pranishëm vetëm në Kosovë. Vepra të tilla kriminale në botë sot janë pothuajse të përditshme. Jo rastësisht në teorinë kriminalistike këto veprime njihen si kriminaliteti i “jakave të bardha” dhe përsosmëria e tyre mund të arrijë perfeksionin.

Vendet e rajonit si Kroacia, Serbia dhe Shqipëria deri më sot kanë ligjet e tyre apo të ashtuquajturën ‘paketën e ligjeve anti-mafia’. Aktualisht Bosnje e Hercegovina dhe Kosova janë të vetmet shtete në rajon që nuk e kanë të miratuar këtë lloj ligji që rregullon kornizën institucionale ekzekutuese për administrimin e pasurive të konfiskuara ose të sekuestruara që janë përvetësuar në mënyrë të paligjshme. Për dallim nga Kosova, Bosnje e Hercegovina e ka të rregulluar pjesërisht këtë gjë nëpërmjet ligjit penal të saj. Ndërkaq Kroacia, Shqipëria dhe Serbia në legjislaturën e tyre kanë të miratuar këtë paketë ligjesh, ku nuk përfshihet vetëm ligji për konfiskim të pasurisë, por një sërë ligje të tjera të kësaj natyre.

P.sh. Kroacia dhe Serbia në paketën anti-mafia kanë nga 4 ligje, të cilat janë të përputhshme mes vete, përkatësisht Ligjin për luftimin e korrupsionit, atë për konfliktin e interesave, për krimin e organizuar dhe trafikimin, si dhe ligjin për konfiskimin e pasurisë. Shqipëria po ashtu ka bërë një ligj për konfliktin e interesave, ku shumë qartë përcaktohet se asnjë zyrtar, i cili punon në organet publike, e njëherësh është ndërmarrës privat, nuk mund të marrë asnjë punë publike përderisa qëndron në atë

<sup>12</sup> Poaty, Neni 10





post. Po ashtu edhe ligji për konfiskim të pasurisë përcakton qartë fushë veprimtarinë dhe kompetencat e tij.

## KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Sipas analizës së mësipërme, vërehet se Kosova ende nuk e ka miratuar Legjislacionin kornizë për konfiskimin e pasurisë, ndonëse kryeministri Hashim Thaçi ka pohuar ta ketë iniciuar një gjë të tillë nga mesi i 2010-ës.

"Kam iniciuar nxjerrjen e ligjit anti-mafi që nënkupton parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit, të vënies së masave parandaluese kundër pasurisë. Ky ligj i cili do të përcaktojë procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër personave që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Pastaj qëllimi i këtij ligji do të jetë parandalimi dhe goditja e krimin të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale." Sipas tij, ky ligj do të punohet nga ekspertët vendës në konsultim me ata të Komisionit Evropian dhe në harmoni të plotë me standardet e kërkuara të Bashkimit Evropian.<sup>13</sup>

Sidoqoftë, është e qartë se fillimisht duhet të sqarohet se çka nënkuptohet me pasuri të fituar në mënyrë të paligjshme. A nënkupton kjo vetëm atë që cilësohet si dobi pasurore, siç përkufizohet me KPK-në, apo ky nocion është më i gjerë dhe më kompleks.

Maksima latine "*Nullum crimen, nulla poena sine lege praevia*", edhe pse i referohet një konteksti tjetër, është më se e nevojshme të zbatohet edhe në ligjin për konfiskim të pasurisë së këtillë, pasi që mos-kodifikimi krijon mundësi dhe lë zbrazëtira të shumta për interpretim.

Gjithashtu vihet re se ligji duhet qartë ta përcaktojë se pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme bëhet në mënyra të ndryshme joligjore dhe ligjore. Ligji duhet të përcaktojë se prejardhja e një pasurie duhet të dëshmohet dhe arsyetohet nga ana e vetë bartësit dhe poseduesit të saj dhe jo që pasurinë e tij ta dëshmojë ose arsyetojë shteti.

Duke i kërkuar një personi fizik ose juridik të dyshimtë që të dëshmojë prejardhjen e pasurisë që pretendon se e zoton e vë atë në sprovë të madhe. Kjo pasi që shteti është i kufizuar ta bëjë atë për arsye se ligjet dhe procedurat e brendshme që e kufizojnë atë. Për shembull, shumë veprimtari ekonomike dhe persona juridik që sot ekzistojnë në Kosovë operojnë në mënyrë legale, dhe nëse organet e drejtësisë hetojnë veprimtarinë

<sup>13</sup> Inicohet ligji anti-mafia, KOHAnet, 12 korrik 2010, <http://www.koha.net/index.php/?cid=1,22,28188> (qasur më së fundi më 15/04/2011)



e tyre zakonisht nuk do të nxirren rezultatet e kërkuara. Mirëpo, një gjë të tillë me ligj i obligon vetë këta persona që të dëshmojnë prejardhjen e pasurisë së tyre edhe atëherë kur dyshohet të ketë pista të mjaftueshme për t'i hetuar, ndonëse një gjë e tillë është e vështirë nëse bëhet vetëm nga informacionet e ofruara nga ana e tyre.

Pasuria përvetësohet shpeshherë jashtë një territori të caktuar, ndërsa fryti i saj investohet legalisht diku tjetër. Prandaj, paketa e ligjeve anti-mafia në Kosovë duhet të përfshijë një gamë të gjerë ligjesh, të cilat do të rregullojnë me saktësi mënyrën e fitimit të pasurisë dhe ndërlidhjen e saj mes vete, sepse për vepra të tillë të kundërligjshme nevojitet një rrjet tepër i organizuar, i sofistikuar dhe kriminal.

Ligji i tanishëm për konflikt të interesit duhet të ndryshohet sa më parë, kurse Kodi Penal është në procedurë. Shumë njerëz janë pasuruar pikërisht përmes keqpërdorimit të pozitës zyrtare, si p.sh. ata që kanë qenë të përfshirë në procesin e privatizimit. Këtu hyjnë edhe ligje të posaçme për kriminalitetin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore, dhe kundër prostitucionit.

Pa një paketë të tillë ligjore, dhe pa u siguruar se të gjitha ligjet në fjalë janë në harmoni me njëri-tjetrin nuk ka mundësi të krijohet një bazë të fortë ligjore. Prandaj, në këtë kontekst, nuk mund të ketë një ligj të mirë për konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe ligje të tjera të kësaj natyre.